

VENDIM
Nr. 321, datë 14.11.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GERTI” SHPK,
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HIDROCENTRALI “MIRESHI” ME FUQI TË INSTALUAR 1.900 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2360/1 prot., datë 10.11.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Gerti’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentrali ‘Mireshi’, me fuqi të instaluar 1.900 mw, me vendndodhje në përrroin e Mireshit, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 1.900 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2360 prot., datë 2.11.2023, paraqiti aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentrali “Mireshi”, me vendndodhje në përrroin e Mireshit, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 1.900 mw.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, e cila sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk është e plotë. Shoqëria në vijim të kryej pjesën e mbetur të pagesës për aplikimin për pajisje me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, para se ERE të shprehet me vendim përfundimtar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Gerti” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, të rregullores, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a” dhe “c”, si dhe për pikën 2, germat: “a”, “b”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni si vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimin e gjendjes gjyqësore nga drejtoria e burgjeve për shoqërinë “Gerti” sh.p.k.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “b”: shoqëria ka bërë me dije se ka përfunduar plotësisht ndërtimin e veprës, në kuadër të kërkesave të kësaj pike të rregullores, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion mbi mënyrën e financimit të ndërtimit të tij me fonde të vetat, apo financim nga të tretë (kredi bankare etj.).

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

- germa “c”: shoqëria ka depozituar në ERE miratimin e pikës së lidhjes nga OSSH sh.a. për një kapacitet të ndryshëm nga ai i miratuar në kontratën me MIE-n, si e tillë shoqëria në vijim të depozitojë në ERE informacion, në lidhje me arsyen e këtij miratimi kapaciteti, i cili rezulton të jetë i ndryshëm nga ai i kontratës me autoritetin kontraktor.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Mireshi”, me vendndodhje në përroin e Mireshit, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 1.900 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti